

**Elementët e ngjashmërisë dhe intonacionit
narrativ midis Kutelit, Turgenievit dhe Gogolit**



Literature

Keywords: Uist, Kumar, kukudh, hije, orë, zana, xhindë, tingullimitime, urimet, mallkimet, shprehjet frazeologjike.

Rovena Vata

Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë. Shqipëri.

Arburim Iseni

**Fakulteti Filologjik. Programi Studimor i Gjuhës dhe Letërsisë
Angleze. Universiteti Shtetëror i Tetovës, Maqedoni.**

Abstract

Në krijimtarinë letrare të shkrimtarëve Mitrush Kuteli, Nikolaj Gogoli dhe Ivan Turgenievit, ndonëse ata i përkasin kulturave të ndryshme, asaj shqiptare dhe ruse, kanë si urë lidhëse folklorin si dhe joshjen ndaj tij. Duke ditur se Mitrush Kuteli qëndron midis tradiconales dhe modernës më shumë anon nga modernja. Kjo për vetë faktin e formimit të tij si një nga prozatorët më të shquar në Shqipëri.

Gogoli, Turgenievi dhe Kuteli janë autorë, të cilët i përkasin kombësive të ndryshme, por duket se letërsia është caq e fuqishme sa këta tre shkrimtarë mund të qëndrojnë fare mirë pranë njëri-tjetrit për arsye studimi. Ndonëse këta tre shkrimtarë i takojnë dy letërsive të ndryshme, përkatësisht Gogoli dhe Turgenievi letërsisë ruse dhe Kuteli letërsisë shqipe, në disa aspekte estetike janë tre shkrimtarë, që përafrojnë, sepse letërsia është një enë komunikuese mjaft efikase për t'i parë këta tre shkrimtarë përballë njëri-tjetrit.

Ngjashmëritë mes tyre i gjejmë në disa elemente, si:

(a) Struktura e dyfishtë:

Nga njëra anë paraqitet ajo që duket kalimtare dhe e paqëndrueshme, por që në realitetin artistik është e përjetshme, sepse koha bëhet mjeti i lëvizjes mendore, psikologjike dhe të vetë syzheut në prozën e këtyre të treve.

- Është mjaft prezente “*prania e mungesës*”, prania e jetës së pasvdekjes apo e vetë vdekjes si nocion i përgjithshëm.

- *Paraqitja e personazheve si individë*, që kanë humbur rrugën e zotit, individë përvuajtës dhe mëkatore në të njëjtën kohë.

- *Paraqitja e e ngjarjeve në planin realist*. Tek Gogoli dhe Turgenievi gjejmë realitetin e Rusisë dhe tek Kuteli shohim realitetin e Shqipërisë. Kur them realitet nuk do të thotë, se proza e tyre është tërësisht realiste, sepse në prozën e tyre është shumë e ndjeshme fryma e imagjinatës, me të cilën është ushqyer realiteti letrar.

(b) Oraliteti në gjuhë, elementet e prozës gojore dhe mimikria:

Element ky, që të bën të mendosh, se proza e tyre do të tingëllonte më bukur e vënë në skenë. Prania e formave të shkurtra të prozës gojore: urimet, mallkimet, përshendetjet, shprehjet

frazologjike, shprehjet e gjuhës së përditshme janë të shpeshta në tekst. Me këtë sy është parë edhe nga kritika, për shkak të këtij oraliteti mjaft prezent në krijimtarinë e tyre.

Ndërtimi i tekstit me mjete artistike të imazhinizmit, si mimika dhe gjestikulacioni, mjete të fuqishme dhe bashkëvepruese me njëra-tjetrën gjatë procesit krijues.

(c) *Prania e elementit fantastik dhe fantazmagorik:*

Elementi, i cili përfshin ëndrrat, fantazitë, prirjet ndaj alegorisë e shumë të tjera. Realiteti dhe fantazia janë gërshetuar mjaft mirë, sa të mund t'i konsiderojmë si dy faqe të së njëjtës medalje ose si substanca të të njëjtit produkt, fruti i të cilave është vetë teksti i përfutur nga reaksioni i këtyre të dyjave. Paraqitja e shpeshtë e *xhindëve*, *djajve*, *magjistricave*, *orëve*, *zanave*, *kukudhëve*, *lugetërve*, *satanait*, *hijet*, *Të Bardhat etj.*

(ç) *Alegoria e veseve dhe virtyteve:*

Të njeriut në realitetin ku ai bën pjesë, aq sa vështirë se mund të përcaktosh kufijtë mes tyre. Pozicionimi i individit mes botës së të gjallëve dhe të vdekurve, ku kufijtë e kohës dhe hapësirës janë shuar.

(d) *Fantazia tepër e zhvilluar:*

Fantazi, e cila premton të n'a çojë tek e vërteta, ku ëndrrat dhe imagjinata bëjnë që të pengohemi në perceptimin mbi kohën, ku e ardhmja zë vendin e së tashmes dhe anasjelltas. Ndjesia e realitetit mosmirënjohës dhe ëndrrës për të prekuar idealin e lartë, por që e ndjek nga pas pamundësia për t'a arritur atë.

(dh) *Simbolika e numrave:*

Numër ky, i cili është i veshur me domethënie të veçantë, që prej antikitetit, kohës kur simbolika e numrave ishte tepër e përdorur prej shkrimtarëve të asaj kohe. Mjeti simbolik që përdorin këta shkrimtarë është i njëjtë, por emërtuar ndryshe.

(e) *Përdorimi i tingullimitimeve:*

Si p.sh: drak-druk, tak-tak, shkrap-shkrup, ding-dong, brram-brrum, ding-ding, pllaq-plluq, drang-drung, zdrang-zdrung, lluk-lluk, bum-bum, fësh-fësh, tang-tung, bang-bung, dangërdungër, bambër-bumbër, çingër-mingër, gau-giu, bum- bum, tak-tuk, drang-drang, fiu-fiu, krik-krik, drëng-drëng, tang-tang, pllaf-plluf, zhgane-zhgane, (shembuj të shkëputur nga tregimet dhe rrëfenjat e të tre shkrimtarëve).

(ë) *Përdorimi i "lojës":*

Si element simbolik në paraqitjen e lëvizjes psikologjike dhe mendore të individit përballë jetës dhe vdekjes. Lojë, që tek Gogoli dhe Turgenievi emërtohet "*Uist*" dhe tek Kuteli "*Kumar*", ku vetitë apo ndjesitë, që të falin këto lojëra janë të ngjashme me ato, që provon njeriu kur gjendet në betejën e humbur përballë vdekjes.

(f) Qëndrimi ndaj recipientit:

Marrëdhënia e ngushtë mes shkrimtarit dhe lexuesit (“dëgjuesit” sipas gjuhës së kritikës), si të ishte një bashkëbisedim mes tre palëve. Këndvështrimi ynë për këta tre shkrimtarë nis me elementin narrativ, sepse mënyra e rrëfimit është kaq e veçantë dhe me një rol kaq të rëndësishëm, sa jo më kot është bërë objekt studimi edhe për shumë kritikë të mëdhenj.

Narracioni është një element i rëndësishëm i estetikës, i mjeteve formale në ndërtimin e teksteve letrare në përgjithësi, por tek këta tre shkrimtarë merr një rëndësi të veçantë, sepse mënyra e rrëfimit bëhet funksion për tekstet e tyre, ku vetë mënyra e të rrëfyerit përbën një rrefim më vete. Narratori fundamental i rrëfimeve të Kutelit mund të karakterizohet si *singer of tales*⁶ (këngëtar epik bëmash, kallëzues historirash), sepse pikësëpari pozicioni narratorial oral është bartur drejtpërdrejt, shëmbëllyeshëm, madje-madje, imitueshëm rrëfimeve gojore. Narratori i Kutelit nuk është rrëfimitar që sajton e shkruan aty për aty. Kuteli, që në nismë të shumë rrëfejavave të tij, dëshmon referenceën përrallore a gojore përgjithësisht, duke shkruar: *sipas një përralle të dëgjuar/ sipas një legjende etj*⁷. Në esencë, ai është bartës i një rrëfimi të dëgjuar. Një status ky tipik për narratorët oralë, në rrëfimet dhe sagat gojore.

Mënyra e fokalizatorit (narratorit) dhe mënyra e drejtëpërdrejtë e ndikimit të rrëfimit te këta tre autorë është e tillë, që në rolin e lexuesit, duket se fitojmë edhe pak nga stasusi i shkrimtarit, sepse shpeshherë ata përdorin disa shprehje ose fraza të tilla, që t’a japin këtë ndjesi, si: “*Ju e dini se*”, “*Këta s’duhet lënë pa përmendur se*”, “*Ju sigurisht do të keni patur rastin të dëgjoni se*”, “*Këto të gjitha këndonjësi do t’i mësojë dalngadalë dhe në kohën e duhur, në qoftë se do të ketë vetëm durim të këndojë tregimin tonë shumë të gjatë*”, “*Merreni vetë me mend*”, “*Gjykoni ju vetë se si unë tani*”, “*Në qoftë se ia thamë këto lexuesit këtë e bëmë që ta dije se kjo gjë ishte e domosdoshme e nuk mund t’i jepnin një emër tjetër*”, “*Po pikësëpari duhet t’i them lexuesit se ku do t’i merrte ato dyzet rublat që përmendëm më lart*”, “*Ju sigurisht do të keni pasur rast të dëgjoni*”, “*Ju pandehni se*”, “*Keni parë se*”, “*Desha t’ju them*”, “*Desha t’ju them*”, “*Ju keni dëgjuar nga etërit dhe gjyshërit*”, fraza këto të përdorura dendur nga Gogoli tek tregimi “*Manteli*”⁸.

Një tipar të tillë e gjejmë njëkohësisht edhe tek “*Natë vjeshte*” e Kutelit kur ai shkruan: “*Dëgjoni apo jo*”, “*Një herë e një kohë*”, “*Po ku e preva fjalën se?*”, “*Urdhëroni e dëgjoni dy fjalë që do ju them*”, “*Prandaj lutem këndonjësit të mbajë vesh e të dëgjojë disa nga andrallat e tete Ngjelos*”, “*Ti, lexonjës, je i pari që po mëson të fshehtën time të madhe të asaj kohe, prandaj të lutem të mos ia thuash askujt*”, “*Më flisni, ju që lëçitni: kush?*”, “*O motra lëçitëse e ju vëllezër lëçitës!*”⁹.

⁶ Lord, Albert B.: “The Singer of Tales”, Harvard University Press, Cambridge, Massachusetts, London, England, 1981. f. 21.

⁷ Rrahmani, Kujtim: Intertekstualiteti dhe oraliteti”, Kuteli, Koliqi, Pashku, “AIDK”, Prishtinë, 2000, f. 143.

⁸ Gogoli, Nikolaj: “Tregime dhe novela”, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1987, f. 512.

⁹ Kuteli, Mitrush: “Vepra letrare 2”, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990, f. 110-245.

“Përralla që do të të rrëfej tanithi na ka ardhur gojë më gojë nga moti i lashtë e stërlashtë, kur të gjithë kafshët e tokës, gjithë shtërpinjët e ujit e gjithë shpesët e qiellit flisnin gjuhën e njerëzve, siç flas unë e siç flet zotrote, o këndonjës....Prandaj, o këndonjës, mos u çudit kur do të dëgjosh se në përrallën tonë kafshët, shtërpinjët e shpendët do të flasin si njerëz. Kështu ka qenë njëherë e njëkohë”¹⁰.

Kurse Turgenievi shkruan kështu: “Dëgjoni pra, o zotërinj”, “Po më falni, o zotërinj”, “duhet t’i tregoj lexuesit përse e vështroja me kaq simpati Arinën”, “më lejoni t’ju tërheq vëmëndjen”, “më lejoni t’ju tregoj, me që ra fjala, një ngjarje të vogël”, “tani, s’ka dyshim se lexuesi e kupton përse e shikonja me kaq keqardhje”, “të cilin lexuesit e mij dashamirës e dijnë prej kohe”, “duhet t’i tregoj lexuesit përse e vështroja”, “i lutem lexuesit të më lejojë”, “me të cilin dua t’u bëj të njohur tani lexuesve”, “Ja se ç’më ka ndodhur”, “Me lejën e lexuesit”, “Merrni me mënt, o lexues të dashur”, “Siç e di lexuesi”, “Dëgjoni, o vëllezër”, “Dëgjoni ç’ka ndodhur”, “Jo, shiko ç’ka ndodhur”, “Jepmë dorën, o lexues i dashur dhe eja me mua”, “Tunjatjeta, o lexues; të uroj të jesh gjithënjë shëndoshë e mirë”, “Dëgjoni se ë’dua t’ju them”, “Besoj se shumë pak nga lexuesit e mij kanë patur rastin të hyjnë nëpër ato pijetoret e fshatit”¹¹.

Këta janë shembuj, të cilët n’a shërbejnë mjaft mirë për të vërtetuar, se ajo që sapo thamë më lart është tërësisht e vërtetë.

Mënyra e rrëfimit në prozën e këtyre tre shkrimtarëve është e tillë, që të jep idenë e një bashkëbisedimi midis lexuesit edhe shkrimtarit, aq sa e bën lexuesin t’a ndjejë veten në statusin e një bashkëautori.

Ky tipar, mjaft specifik për këta tre shkrimtarë është veçuar edhe nga kritika, qoftë ajo shqiptare, qoftë ajo e huaj.

Përmendim S. Hamitin, lidhur me këtë veçori, i cili është shprehur se: “*Thelbi është se Mitrush Kuteli nuk rrëfen ngjarje, por rrëfimin mbi ngjarjen. Ndaj, autori merr një rol të ndërmjetësit midis rrëfimit me dëgjuesin apo me lexuesin*”¹². Ndaj, unë i bashkangjitem mendimit të këtij kritiku të letërsisë shqipe, sepse vetë teksti m’a jep këtë të drejtë për të qënë absolutisht dakort. Rastet që përmendëm më lart janë dëshmia më e mirë për këtë.

Njëkohësisht, një ndër kritikët e huaj është edhe B. M. Ejhenbaum, i cili hedh po të njëjtin mendim, por formuluar kështu: “*Kompozicioni i novelës varet në një shkallë të lartë prej faktit se çfarë roli luan në thurjen e saj toni personal i autorit*”¹³.

Zëri i rrëfimitarit ndjehet së tepërmi, madje është i dallueshëm prej syve të kritikës dhe mjaft i rëndësishëm në vetë tekstin letrar. Kjo mënyrë e rrëfimit përfron së tepërmi më mënyrën e të treguarit në përrallë.

¹⁰ Kuteli, Mitrush: “Tregime të moçme shqiptare”, Përralla “Xinxifilua”, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990, f. 267.

¹¹ Ivan, Turgenievi: “Kujtimet e një gjahtari”, “Ndëmmarrja e Shtetërore e Botimeve”, Tiranë, 1955, f. 231.

¹² Hamiti, Sabri: “Letërsia moderne shqiptare”, “UET-Press”, Tiranë, 2009, f.126.

¹³ Ejhenbaum, B: “Mbi prozën”, “Lehningrad-Hudozh”, 1986, f. 43.

Tipar ky, që është pranuar edhe nga vetë M. Kuteli në një nga intervistat e tij ku ai është shprehur se: “...përrallat e dëgjua ose të lexuara më mbrujtën në një moshë të njomë. Tregimet e njerëzve dhe sidomos të pleqve, pranë zjarrit, nën hijen e druve, ngjarje të moçme, luftrat, ngjarje të mërgimit janë brumi, që më kanë formuar”¹⁴.

Duke marrë shkas nga kjo, shkrimtari dhe kritiku A. Plasari ka hedhur mendimin se: “Kemi të bëjmë me një shkrimtar, forminimi i të cilit paraqitet pikë së pari mbi bazën e krijmtarisë gojore”¹⁵.

Ndërkohë, që vetë ne si studiues të letërsisë nuk duhet të harrojmë, se ky shkrimtar është një ndër mbledhësit kryesor dhe më të rëndësishëm të folklorit. Kështu që, nuk ka se si të mos këtë ndikuar ky fakt në botën artistike të novelave të tij apo sië quhen ndryshe nga vetë ai të “rrëfenjave” të tij.

Paralelet që ne vendosim midis Kutelit, Gogolit dhe Turgenievit i ka fillesat në një konstatim, që vetë Kuteli ka bërë në një intervistë është shprehur: “Në vitet e rinisë sime kur unë sapo kisha mësuar frëngjishten, nisa të lexoj shumë shkrimtarë të letërsisë së huaj dhe më ka bërë përshtypje më të madhe se sa Gogoli, sidomos me Taras Bulbën, po ashtu edhe Turgenjevi”¹⁶.

Kështu, në mund të mendojmë se kjo mënyrë e të rrëfyerit e Kutelit ka disa arsye të forta, të cilat rezultojnë të jenë dy:

- (a) *Puna e tij si mbledhës i folklorit.* Raporti i ngushtë me folklorin si një faktor i rëndësishëm, i cili ka ndikuar në mënyrën se si ai i ndërron tekstet e tij letrare. Kjo është e dukshme në fushën e narracionit, sepse përdorin modelet e prozës gojore veçant përrallës.
- (b) *Ndikimet nga leximet e veprave të Gogolit dhe Turgenievit,* që për Kutelin janë dy shkrimtarë të veçantë, nga të cilët duket se është frymëzuar shumë, aq sa mund të themi se mund të kenë qenë njëri ndër udhërrëfyesit e tij artistik për teknikën e tij narrative gjatë krijimit.

Këto tregojnë qartë për raportin e ngushtë, që është vendosur mes shkrimtarit ose rrëfyesit me vetë lexuesin, i cili shpesh është trajtuar si dëgjues prej kritikës. Një raport të tillë kaq të afërt e gjejmë edhe tek Gogoli kur ai ndërftoi disa shprehje, të cilat e realizojnë këtë, si tek Tregimi “Hunda” kur ai shkruan:

“Duhet të dini se”, “Ju do ta merrni vesh më vonë se”, “Ky është një trillim që”, “përpara lexuesve”, “që ju lexues do ta mësoni në kapitullin e mëvonshëm se”, “Më është lodhur dora e nuk shkruaj dot ngaqë”, “Do të ishte e tepërt të përshkruaja”, “Ja kështu ka ndodhur”¹⁷.

Për t’a kuptuar më mirë këtë raport të ngushtë, që Gogoli, Turgenievi dhe Kuteli kanë me përrallën, mund të veçojmë disa fraza të ngjashme me ato të përrallës, që i gjejmë në rrëfenjat e Kutelit tek “Vendosa të shkoj në mërgim” ku ai shkruan: “Një ditë”, “Na ishte një herë”,

¹⁴ Nasho Jorgaqi: “Estetika e gjuës shqipe”, “Onufri”, Tiranë, 1996, f. 65.

¹⁵ Plasari, Aurel: “Kuteli mes të gjallëve dhe të vdekurve”, Apollonia, Tiranë, 1995, f. 31.

¹⁶ Po aty, f. 34.

¹⁷ Gogoli, Nikollaj: “Tregime dhe novela”, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1987, f. 411-434.

shprehje, të cilat përngajnë së tepërmi ose janë të njëjta me hyrjet me që përdoren nëpër përralla të ndryshme. Gjithashtu, edhe Gogoli në novelën “Kukudhi” shkruan: “Një herë e një kohë”, “Ish seç na ish një mullixhi me të shoqen që”, “Një ditë prej ditësh”, “Një herë”.

Po edhe Turgevievi ec në të njëjtën rrugë me Gogolin kur shkruan: “Një herë, në vjeshtë”, “Ish një ditë”, “Kjo ngjarje ka ndodhur shumë kohë më parë”, “Sot e shumë kohë më parë në vjeshtë”, “Njëherë në vjeshtë”, “Një herë, një ditë vere me vapë”¹⁸.

“Njëra nga çupat, më duket Nastasia, nisi të na rrëfente më zë të platitur (zë nate), shtruar-shtruar, një përrallë që na dukej se nuk do të kish të sosur: “Ish mos na ish. Ish një mullixhi me të shoqën”¹⁹.

Nga një pozitë e ngjashme rrëfimore dhe me fuksion të njëjtë rrëfen edhe narratori i Mitrush Kutelit: “Njëra nga çupat, më duket Nastasia, nisi të na rrëfente më zë të platitur (zë nate), shtruar-shtruar, një përrallë që na dukej se nuk do të kish të sosur: “Ish mos na ish. Ish një mullixhi me të shoqën”²⁰. Ose: “Mirë thotë kush thotë: “I riu me të rinë, plaku me pleqërinë. Mirë thotë dhe ai tjetri: “I riu me të rinë si prilli me bukurinë”. Kështu thonë të urtët, po ja ç’ka ndodhur njëherë”²¹.

Dallohet qartë nga teksti, se kur përmendim këta tre shkrimtarë duhet të kemi parasysh, që kemi të bëjmë me krijues, të cilët nuk rrëmben nga frymëzimi dalldisës gjatë procesit të krijimit, siç ndodh rëndomtë me shkrimtarë të tjerë. Kemi të bëjmë më tre shkrimtarë, që gjatë procesit të krijimit janë tërësisht të vetëdijshëm për atë që shkruajnë, ç’duan të shkruajnë dhe se si do t’a shkruajnë, të qartë se për çfarë do të shkruanjë, aq sa vetë mënyra e të rrëfyerit përbën një rrëfim më vete. “Të përmendësh procesin e të thënit brenda thënies do të thotë të përftosh një thënie. Rrëfimi që buron vetveten nuk mund të ndërpritet asnjëherë përveç se arbitrarisht, sepse gjithnjë mbetet të tregohet një rrëfim, të thuhet se si ka mundur të dalë në dritë ky rrëfim, i cili është duke u shkruar apo duke u lexuar”, shprehet Todorov²².

Ka rëndësi mjaft të madhe kjo që ai ka shprehur, aq sa vlen të përmendet pikërisht për mënyrën e të rrëfyerit të këtyre tre shkrimtarëve, të cilët përdorin këto mjete apo teknika të përbashkta narrative gjatë procesit të tyre krijues. Mjete, që i përmendëm më lart duke i shkëputur nga teksti, që i përgjigjen mjaft mirë këtij mendimi që ka shprehur Todorovi.

Kështu, ne formulojmë idenë, se narracioni tek këta autorë është i rëndësishëm, sepse përbën rrugën, që procesi krijues kalon gjatë realizimit të tij duke përdorur si mjet udhëtimi, pikërisht këto teknika që lartpërmendëm. B. Suta për M. Kutelin shprehet se: “Proza e tij synon që të përqafojë realizimin e kodifikimit të tij narrativ”²³.

¹⁸ Turgenievi, Ivan: “Kujtimet e një gjahtari”, “Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve”, Tiranë, 1955, f. 117.

¹⁹ Kuteli, Mitrush: “Vepra letrare 2”, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990, f. 130.

²⁰ Kuteli, Mitrush: “Vepra letrare 2”, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990, f. 130.

²¹ Kuteli, Mitrush: “Tregime të moçme shqiptare”, Përralla: “Plaku dhe vasha”, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990, f. 260.

²² Todorov, Tzveton: “Poetika e prozës”, “Libri-Panteon”, Tiranë, 2000, f. 22.

²³ Suta, Blerina: “Pamje të modernitetit në letërsinë shqipe”, “Onufri”, Tiranë, 2005, f. 85.

Teksti është ai që i shërben narracioni si element apo mënyrë e thënies për tekstin. Në të vërtetë, narracioni dhe teksti mund t'i zënë vendin njëri-tjetrit. Vetë rrëfimi është edhe tekst edhe proces apo mënyrë e të thënit ose më mirë të themi, që ato i shërbejnë njëra-tjetrës në mënyrë të ndërsjelltë. Sipas Blerina Sutës: *“Episodet bashkohen përmes zërit të rrëfimitarit, i cili u drejtohet rrëfimndjekësve duke i'u tërhequr vëmendjen herë pas here dhe duke hamendësuar debat për realitetin që ai po rrëfen”*²⁴.

Këto që thotë ajo është tërësisht e vërtetë, sepse këtu duhet të ketë patur parasysh kur në tekstin e tyre gjejmë fraza si: *“Nësë s’e mbani mend po ju them unë se”*, *“Duhet t’a keni marrë me mend se”*, fraza këto, që i takojmë shpesh tek *“Qetësi përpara furtune”*²⁵ e Kutelit, që i gjejmë edhe tek Gogoli në novelën *“Nata përpara Kërshëndellave”* si p.sh: *“Ju e dini mjaft mirë se”*, *“Së pari duhet t’ju informoj ju lexues se”*²⁶, si dhe në tregimin *“Jermollai edhe e shoqja e Mullisit”*, të Turgenievit gjejmë: *“Më lejoni t’ju tërheq vëmendjen se”*, *“Ju e dini mirë se”*, *“Të them të vërtetën që”*²⁷.

Shkrimtari jo vetëm që është në dijeni të asaj që vetë po rrëfen dhe të asaj që ka dëgjuar për të cilën po rrëfen, por shkon aq larg sa të ketë pretendimin se mund të parashikojë edhe se ç’mund të jetë duke menduar lexuesi apo dëgjuesi gjatë kohës kur ai është duke rrëfyer. Kjo është një mënyrë mjaft e mirë e shkrimtarit për të vendosur urat lidhëse të komunikimit midis vetes dhe lexuesit.

Si përfundim mund të themi se:

Gjatë studimit jemi përqendruar të shqyrtojmë esencën e tregimeve të Kutelit në intertekst me tregimet e Gogolit dhe Turgenievit duke u ndalur tek pikat, që bijnë më në sy, siç është trajtimi i fantastikës dhe fantazmagorikës, oraliteti, elementet e prozës gojore, përdomimi i lojës dhe alegorisë në një linjë me Gogolin dhe Turgenievin si trajtimi i elementit të vdekjes, jo si trishtim, por si diçka e natyrshme dhe e zakonshme.

Element tjetër dominues për krijimtarinë e këtyre shkrimtarëve janë edhe elementet folklorik ku trajtohen fakte të mundshme dhe të pamundshme, e zakonshmja dhe e pazakonshmja, realiteti dhe trillimi.

Gogoli në rrëfenjat dhe novelat e tij flet për njerëz të thjeshtë e të fortë, të rinj që dëfrejnë e dashurojnë, për çifte që luftojnë për lumturinë e tyre. Bashkë me njerëzit, ashtu si në legjendat popullore, veprojnë shtrigat, kukudhët djajtë. Fantastikja nga Gogoli përdoret me mjeshtëri e me një origjinalitet të rradhë. Ajo nuk qëndron jashtë jetës së përditshme, por përzihet më të, aq sa nuk e dallon ku është e vërteta e ku nis trillimi.

²⁴ Po aty, f. 85.

²⁵ Kuteli, Mitrush: “Vepra letrare 2”, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990, f. 345.

²⁶ Gogoli, Nikolaj: “Tregime dhe novela”, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1987, f. 459.

²⁷ Ivan, Turgenievi: “Kujtimet e një Gjahtari”, “Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve”, Tiranë, 1955, f. 35-36.

Krijimtaria popullore i ka përfytyruar kurdoherë qeniet mbinjerëzore si pjesëmarrëse në jetën e përditshme të njeriut, që bashkëveprojnë me njeriun, e ndihmojnë ose e pengojnë atë. Kështu vepron edhe Gogoli.

Figurat e dajve, të shtrigave etj, Gogoli i paraqet në formë komike e familjare, ashtu siç është karakteristikë për konceptimin popullor të këtyre personazheve përrallore, por interesante është të vërehet se materialin e fantazisë popullore e bën, si të thuash, tokësor, madje edhe e ç'mitizon.

Bibliografia

1. Ejhenbaum, B: *“mbi prozën”*, “lehingrad-hudozh”, 1986.
2. Gogoli, Nikolaj: *“tregime dhe novela”*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1987.
3. Gogoli, Nikolaj: *“tregime dhe novela”*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1987.
4. Gogoli, Nikollaj: *“tregime dhe novela”*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1987.
5. Hamiti, Sabri: *“letërsia moderne shqiptare”*, “Uet-Press”, Tiranë, 2009.
6. Ivan, Turgenievi: *“kujtimet e një gjahtari”*, “ndërmarrja e shtetërore e botimeve”, Tiranë, 1955.
7. Ivan, Turgenievi: *“kujtimet e një gjahtari”*, “ndërmarrja shtetërore e botimeve”, Tiranë, 1955.
8. Kuteli, Mitrush: *“tregime të moçme shqiptare”*, përralla “xinxifilua”, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990.
9. Kuteli, Mitrush: *“vepra letrare 2”*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990.
10. Kuteli, Mitrush: *“vepra letrare 2”*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990.
11. Kuteli, Mitrush: *“vepra letrare 2”*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990.
12. Kuteli, Mitrush: *“vepra letrare 2”*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990.
13. Kuteli, Mitrush: *“tregime të moçme shqiptare”*, përralla: “plaku dhe vasha”, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990.
14. Lord, Albert B.: *“the singer of tales”*, Harvard University Press, Cambridge, Massachusetts, London, England, 1981.
15. Nasho Jorgaqi: *“estetika e gjuhës shqipe”*, “Onufri”, Tiranë, 1996.
16. Plasari, Aurel: *“kuteli mes të gjallëve dhe të vdekurve”*, Apollonia, Tiranë, 1995.
17. Rrahmani, Kujtim: *“intertekstualiteti dhe oraliteti”*, kuteli, koliqi, pashku, “aidk”, Prishtinë, 2000.
18. Suta, Blerina: *“pamje të modernitetit në letërsinë shqipe”*, “Onufri”, Tiranë, 2005.
19. Todorov, Tzveton: *“poetika e prozës”*, “libri-panteon”, Tiranë, 2000.
20. Turgenievi, Ivan: *“kujtimet e një gjahtari”*, “ndërmarrja shtetërore e botimeve”, Tiranë, 1955.